



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 15 maj, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit vendosi mbi dy raporte të Zyrës Administrative në lidhje me kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces. Në vendimin e tyre, gjykatësit miratuan kërkesat për pjesëmarrje në proces të katër viktimave dhe hodhën poshtë kërkesën e një viktime.

Rregullorja e DHSK-së u lejon gjykatësve të pranojnë kërkesat e paraqitura pas kalimit të afatit, në qoftë se paraqiten arsye bindëse. Në vendim gjykatësit shpjeguan arsyetimin e tyre për pranimin e kërkesës së secilës nga katër viktimat. Këto katër viktimat do t'i bashkohen grupit të viktimave pjesëmarrëse që përfaqësohen nga Mbrojtësi i Viktimave, Sajmon Loz. Në këtë çështje gjyqësore tani marrin pjesë 156 viktimat.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses vendosi mbi një kërkesë të Prokurorisë për pranimin e dëshmive me shkrim të pesë dëshmitarëve sipas rregullës 155. Kjo rregull i lejon gjykatësit të pranojnë si provë dëshminë e një dëshmitari që është i padisponueshëm të paraqitet në sallë të gjyqit, ose është objekt i ndërhyrjeve, në qoftë se përmbushen disa kushte.

Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën lidhur me një nga dëshmitë me shkrim të propozuar nga Prokuroria. Trupi Gjykses i pranoi dëshmitë me shkrim të katër dëshmitarëve të tjerë, duke theksuar për secilin prej tyre se provat e dëshmitarit përkatës nuk lidheshin drejtpërdrejt me veprimet dhe sjelljet e paraqitura në Aktakuzë. Trupi Gjykses theksoi gjithashtu se vlerësimi përfundimtar i mbështetshmërisë së provave të pranuar do të bëhet në kuadër të tërësisë së provave të pranuar në fund të gjykimit.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake zgjati afatin për Prokurorinë për t'iu përgjigjur mocioneve paraprake të Mbrojtjes në atë çështje. Kjo ishte pas dy zgjatjeve të afatit të miratuara më parë për Mbrojtjen.

Para fillimit të gjykimit, i akuzuari ka të drejtë t'i dorëzojë mocione paraprake Gjykatës së Procedurës Paraprake, me anë të të cilave cilat ai, për shembull, mund të kundërshtojë juridiksionin e Dhomave të Specializuara ose të pretendojë mangësi në formën e aktakuzës. Ekipet e Mbrojtjes kanë dorëzuar pesë mocione paraprake në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e apelit në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës përfundoi të premten e kaluar, 16 maj, pas parashtrimeve nga palët dhe pasi z. Shala iu drejtua personalisht Panelit. Në parashtrimet e saj, Mbrojtja tha,





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr. 20/2025
Hagë, 22/05/2025

ndër të tjera, se dënimet duhet të rrëzoheshin dhe se klienti i tyre duhet të shpallej i pafajshëm për të gjitha akuzat, ndërsa Prokuroria argumentoi se apeli i z. Shala duhej hedhur poshtë në tërësi. Paneli i Gjykatës së Apelit do ta japë vendimin e tij më vonë.

